

Keto Kushte Standarde te Hyrjes Amadeus jane subjekt i termave dhe kushteve te Marreveshjes.

1. Perkufizime

Pervec kur eshte i dukshem nje synim i kundert, termat e perkufizuara ne Marreveshje do te kene te njejtin kuptim kur perdoren ne keto Kushte Standarde te Hyrjes Amadeus. Ne keto Kushte Standarde te Hyrjes Amadeus:

“Marreveshje” nenkupton kontraten e lidhur midis Amadeus dhe Pajtimtarit ne te cilen keto Kushte Standarde te Hyrjes Amadeus jane te inkorporuara nepermjet references.

“Kredencialet e Hyrjes” nenkupton cdo emer perdoruesi, numer identifikimi, fjale kyce, licence apo ciles sigurie, token sigurie, PIN apo kod tjeter sigurie, metode, teknologji apo pajisje te perdorur, vetem apo te kombinuar, per te verifikuar nje identitet individual dhe autorizimin per te hyre dhe perdorur Sistemin Amadeus apo, sipas kerkeses, nje Produkt Amadeus.

“Grupi Amadeus” nenkupton Amadeus dhe entitetet ligjore te grupit, perfishire Amadeus IT Group, S.A., qe zhvillojne, operojne dhe shperndajne Sistemin Amadeus.

“Produkt Amadeus” nenkupton cdo Program apo produkt tjeter apo sherbim qe Amadeus i mundeson Pajtimtarit sipas Marreveshjes.

“Sherbimet Amadeus” nenkupton cdo sherbim pajtimi Programi qe ofron Amadeus per hyrje nga larg dhe perdorim nepermjet Internetit nga Pajtimtari dhe Perdoruesit e Autorizuar te tij (p.sh. Lidhje Platforma e Shitjes Amadeus), se bashku me Dokumentacionin per perdorimin.

“Sistemi Amadeus” nenkupton informacionin e udhetimeve te kompjuterizuar dhe sistemin e shperndarjes qe permban informacionin rreth orareve, disponueshemrise, cmimeve dhe sherbimeve te lidhura dhe nepermjet te cilit mund te behen rezervimet dhe te leshohen biletat. “Sistemi Amadeus” nuk perfishin asnje Internet publik apo poste elektronike qe mund te ofroje Amadeus.

“Sistemi i te Dhenave Amadeus” nenkupton te dhenat/informacionin e disponueshem per Pajtimtarin nepermjet Sistemit Amadeus.

“Perdoruesit e Autorizuar” nenkupton punemarresit, agjentet dhe kontraktoret e Pajtimtarit te cilet i Pajtimtari i ka Autorizuar per te perdorur Sistemin Amadeus, Produktet Amadeus, apo, nese eshte i disponueshem ne territor, Amadeus Direct ne perputhje me kete Marreveshje. Pajtimtari duhet te mbaje nje liste te perditshme te shkruar te Perdoruesve te Autorizuar aktualde dhe t’ia jape kete liste Amadeus brenda 10 (dhjete) diteve nga kerkesa me shkrim e Amadeus e bere ne cdo kohe. Perdoruesit e Autorizuar nuk perfishijne personat apo entitetet te cilet jane punemarres, agjente apo kontraktore te konkurenteve te Amadeus.

“Rezervim” nenkupton cdo rezervim individual ajror (**“Rezervim Ajror”**), dhome hoteli apo dhenie makine me qira (**“Rezervim jo-Ajror”**) te krijuar ne pjesen e itinerarit te nje PNR te rezervuar dhe te procesuar ne Sistemin Amadeus qe: (a) nuk eshte anuluar, nuk eshte konfirmuar apo nuk eshte permbushur; dhe (b) ne rast te nje Rezervim Ajror, ka patur nje bilete apo dokument te ngjashem te leshuar nga Ofruesi apo agjenti i autorizuar i tij (**“Rezervim me Bilete”**). Palet do te konsiderojne se numri i Rezervimeve me Bilete do te korrespondoje me numrin e Rezervimeve Ajrore pervec kur tregohet ndryshe ne regjistrin e automatizuar Amadeus. Per te dhene shembull: (i) nje pasagjer ne nje fluturim direkt te vetem llogaritit si nje Rezervim Ajror; dhe (ii) nje pasagjer ne dy fluturime te ndara lidhese do te llogaritit si dy Rezervime Ajrore.

“Te Dhenat e Rezervimit” nenkupton te dhenat e krijuara nga Pajtimtari ne lidhje nje Rezervim nepermjet perdorimit te tij te Sistemit Amadeus.

“Dokumentimi” nenkupton cdo manual, udhezim perdoruesi, dokument, udhezim apo informacion tjeter qe Amadeus i jep Pajtimtarit per te lehtesuar perdorimin dhe operimin e rregullt te Sistemit Amadeus apo cdo Produkti Amadeus, perfishire ato ne format elektronik.

“ID e Zyres” nenkupton cdo kod unik identifikimi te zyres Amadeus.

“Perdoruesi Online” nenkupton nje udhetar individual i cili perdor nje faqe interneti per te hyre ne Sistemin Amadeus.

“PNR” nenkupton nje regjistrim te emrit te pasagjerit te krijuar ne Sistemin Amadeus.

“Ofruesi” nenkupton nje ofrues te sherbimeve te lidhura me udhetimeve te cilat behen te mundeshme nepermjet Sistemit Amadeus.

“Program” nenkupton programin e aplikacioneve qe Amadeus i ofron hyrje ne distance si pjese e Sherbimeve Amadeus apo per instalimin ne kompjuter nga Pajtimtari, se bashku me Dokumentacionin per te perdorur ate dhe te gjitha versionet e reja, perditisimet, rishikimet, permiresimet, modifikimet dhe zveredimet e ketyre programeve.

“Transaksion” nenkupton nje kerkese per te perpunuar te dhenat e trasmetuara Sistemit Amadeus. Shume elemente te dhenas te trasmetuara Sistemit Amadeus ne vijim llogaritit si nje Transaksion. Elementet e te dhenave te trasmetuara nepermjet udhезuesve, makro, robotikes dhe mjeteve te ngjashme mund te rezultojne ne Transaksione te shumefishta te cilat nuk i shfaqen Pajtimtarit. Amadeus rezervon te drejten te fuse tipe te reja Transaksioni dhe cmime te lidhura me to ne cdo kohe dhe perdorimi i Pajtimtarit te tyre do te perbeje dakortesine e Pajtimtarit per te paguar Pagesat e zbatueshme. Nje “Transaksion i Sistemit Qendror” nenkupton nje Transaksion qe nuk eshte nje transaksion me tarife te ulet ne nje Produkt Amadeus i tille si Cmimi Kryesor.

“Adresa e Internetit” nenkupton cdo faqe interneti apo program telefoni i perdorur nga Pajtimtari per t’i ofruar Perdoruesve Online hyrjen ne Sistemin Amadeus.

2. Hyrja ne Sistemin Amadeus

2.1 Hyrja. Sipas termave dhe kushteve te Marreveshjes, Amadeus i jep Pajtimtarit nje te drejte jo-ekskluzive, te revokueshme dhe te pa-transferueshme, pa te drejten per te dhene nen-licenca, per te hyre dhe perdorur Sistemin Amadeus brenda Territorit vetem per te marre te Dhenat e Sistemit Amadeus. Sistemi Amadeus mund te aksesohet vetem nga Perdoruesit e Autorizuar dhe, sipas Seksionit 6.2 (*Faqja e Internetit e Pajtimtarit*) te ketyre Kushteve Standarde te Hyrjes Amadeus, Perdoruesit Online.

2.2 Sistemi i Dhenave Amadeus. Pajtimtari duhet te perdore Sistemin e te Dhenave Amadeus mund te perdoret vetem per: (a) rezervimin apo shitjen e produkteve dhe sherbimeve te udhetimeve te ofruara nga Ofruesit ne Sistemin Amadeus; (b) t’i dhene informacion udhetime klienteve te Pajtimtarit; (c) leshimin e bileteve, itinerareve te udhetimeve, faturave apo deklaratave; (d) veprimtarite e kontabilitetit dhe mbajtjes se regjistrave te klientit; dhe (e) sherbime te tjera te lidhura me udhetimeve te autorizuar nga Amadeus me shkrim. Pajtimtari nuk do te plotesoje, ruaje, shese, shperndaje apo te beje ndryshe te aksesueshem Sistemin e te Dhenave Amadeus pervec sa lejohet shprehimisht sipas Marreveshjes.

2.3 Aktivitete te Ndaluara. Pajtimtari nuk duhet: (a) drejteperdrejte, jo drejteperdrejte, manualisht apo nepermjet mjeteve robotike te hyje apo perdore, apo te lejojte cdo pale te trete pervec Perdoruesve te Autorizuar te hyje apo perdore Sistemin Amadeus apo cdo Produkt Amadeus per: (i) te beje rezervime te cilat jane spekulative, fiktive, te dubluara, te pappershtatshme apo mashtrime, apo te bera vetem per te arritur targetin minimal te Rezervimeve, kerkesat minimale te perdorimit apo ne forma te tjera te siguroje avantazhe te pappershtatshme ekonomike; (ii) te kryje rezervimin e hapesirave para kerkeses; (iii) te krijojte apo modifikojte ne menyre te pappershtatshme regjistrimet; (iv) te kryje transmetimin e mesazheve personale pervec nga nje sistem poste elektronike; (v) te kryje trajnimin e cdo pale te trete ne perdorimin e Sistemit Amadeus; (vi) te kryje zhvillimin apo publikimin nje gjate rezervimi, bilete, shitje, kargo apo tarifimi; (vii) te angazhohet ne cdo aktivitet jo etik apo te paligjshem; (viii) ofrte me vetedije apo jo, te beje trasmetimin apo shpernapjen e cdo virusi, trojan apo te dhene, pune, kod apo program tjeter me qellim te keq, te demshem apo qe çon ne paafetesi; apo (ix) te nderhyje me, te nderpese apo te tentoje te marre akses te paautorizuar ne cdo kompjuter, sistem apo rrjet; (b) te licensojte, transferoje, caktojte, shperndaje, shfaqe, perhape apo ndryshe te beje te mundshem Sistemin Amadeus apo cdo Program Amadeus per cdo pale te trete pervec Perdoruesve te Autorizuar apo sipas lejimit shprehimisht sipas kesaj Marreveshje; (c) pervec sa mund te lejohet nga cdo ligj i zbatueshem i cili eshte i mundshem te perjashtohet me marreveshje midis Paleve dhe pervec sa lejohet shprehimisht sipas Marreveshjes: (i) te tentoje te kopjojte, modifikojte, dublikojte, krijojte pune derivative nga kuadri, pasqyra, ripublikimi, shkarkimi, shfaqja, trasmetimi apo shperndaje te gjitha apo cdo pjese te Programit apo Dokumentacionit ne dispozicion ne cdo forme apo media apo nga cdo mjet; apo (ii) te tentoje te zbrazte, te kunder plotesoje, çmontojte, kunder-procesoje apo ndryshe te reduktoje ne formen e perceptueshme nga njeriu te gjitha apo cdo pjese te Programit; (d) hyje ne Sistemin Amadeus apo cdo Produkt Amadeus nepermjet produkteve te paleve te trete (p.sh. mjeteve robotike) te cilat nuk jane shprehimisht te autorizuar me shkrim nga Amadeus; (e) perdore cdo mjet automatik, program, aplikacion, program, perberes shtese te shfletuesit, algoritem ofrte te integruar ne nje shfletues apo ndryshe apo metodologji qe ka procese apo funksionalitet te ngjashem, apo procesi manual, per te monitoruar, kryer cdo transaksion, per t’i dhene forme, modifikojte, shtojte permbajtjen apo kopjojte cdo pjese te Sistemit Amadeus apo cdo Produkti Amadeus; apo (f) te hyje ne te gjitha apo cdo pjese te Sistemit Amadeus apo cdo Produkt Amadeus ne menyre qe te ndertoje nje produkt apo sherbim i cili konkuron me Sistemin Amadeus apo cdo Produkt Amadeus.

2.4 Perdorues te Autorizuar. Pajtimtari duhet te siguroje qe Perdoruesit e Autorizuar te perdorin Sistemin Amadeus dhe Produktet Amadeus ne perputhje me keto Kushte Standarde te Hyrjes Amadeus dhe duhet te jete pergjegjes per cdo shkelje te Perdoruesit te Autorizuar te ketyre Kushteve Standarde te Hyrjes Amadeus.

2.5 Udhezimet e Operimit. Pajtimtari do te jete ne perputhje me cdo udhezim te arsyeshem te dhene nga Amadeus here pas here ne lidhje me operimin e duhur te Sistemit Amadeus apo nje Produkti Amadeus.

2.6 Rezervimet Jo-produktive. Pajtimtari duhet te jete pergjegjes i vetem per te fshire te gjitha Rezervimet e pakonfirmuara, paplotesuara apo te anuluar nga PNR-te.

2.7 Transaksionet. Pajtimtari do te perdore perpjekjet e tij te arsyeshme per te minimizuar numrin e Transaksioneve per Rezervim.

2.8 Modifikimet/Nderprerjet. Amadeus apo te licensuarit e tij, sipas vendimit te tyre munden te ndryshojne, modifikojne, heqin, nderpresin, zveredesoje, perditesoje apo permiresojne funksionet dhe komponentet e tyre, dhe te dhenat e mundesuara nepermjet te gjitha apo cdo elementi te Sistemit Amadeus apo nje Produkti Amadeus pa detyrim ndaj Pajtimtarit. Amadeus do te perdore sjellje te arsyeshme tregtare per te njoftuar Pajtimtarin paraprakisht per cdo veprim te tille thelbesor. Amadeus nuk kerkohet te ofrojte apo te mbaje nje te dhene te vegante apo te dhena per cdo Ofrues te vegante ne Sistemin Amadeus. Pajtimtari nuk do te modifikojte apo ndryshojte Sistemin Amadeus apo cdo Produkt Amadeus.

2.9 Mirembajtja. Amadeus mundet here pas here pa asnje pergjegjesi apo detyrim ndaj Pajtimtarit, te kryje ndalime te programuara per mirembajtjen e Sistemit Amadeus apo cdo Produkt Amadeus. Amadeus do te perdore sjellje te arsyeshme tregtare per te minimizuar dhe dhenat Pajtimtarit njoftim paraprak per cdo ndalim te tille.

2.10 Programi dhe Teknologjia e Pajtimtarit. Pajtimtari nuk mund te integrojte apo te beje nderfaqe te ndonje programi apo teknologjie me Sistemin Amadeus apo nje Produkt Amadeus, apo te kryje cdo operacion tjeter qe mund te ndikojte mbi Sistemin Amadeus apo nje Produkt Amadeus apo hyrjen e Pajtimtarit ne to, pa marre leje paraprake me shkrim nga Amadeus, e cila nuk do te ndalohej apo vonohet ne menyre te paarsyeshme.

Pajisja apo programi i mundesuar nga Pajtimtari apo shitesit e tij per perdorimin e tij ne kombinim me Sistemin Amadeus duhet te perputhet me specifikimet dhe standartet mbizoteruese te Amadeus dhe eshte pergjegjesi personale e Pajtimtarit. Nese ndonje pajisje apo program i tille degradon apo nderhyn ne performancen e Sistemit Amadeus apo cdo Produkti Amadeus, apo ka nje modifikim te paautorizuar te tyre, Pajtimtari do te jete pergjegjes per te gjitha kostot e arsyeshme te bera nga Amadeus per te diagnostikuar dhe eliminuar degradimin, nnderhyrjen apo modifikimin. Amadeus mundet sipas vendimit te tij te arsyeshem te ndryshoje kerkesat e pajisjes apo programit te nevojshme per te operuar Programin apo per te hyre ne Sistemin Amadeus.

2.11 Kontrolli i Pajisjes dhe Programit. Amadeus mund te kryje kontrollin online, nepermjet funksionit te perditesisimit automatik apo tjeter te pajisjes dhe programit te perdorur nga Pajtimtari per te hyre ne Sistemin Amadeus. Si pjese e ketyre kontroleve, Amadeus mund te ruaje te dhenat e meposhtme: tipi dhe shpejtesia e CPU (procesorit) te perdorur, madhesia e RAM, kapaciteti i hard-disk-ut, dhe versioni i sistemit operativ. Amadeus do te perdore te dhenat e ruajtura per te kontrolluar performancen e sistemit, ofrimin e perditesisimeve automatike, eliminimin e keq-funksioneve, verifikimin e faturimeve apo ofrimin e lloj te tjera te suportit.

3. Pezullimi i Hyrjes / Leshimit te Biletave

3.1 Pezullimi i Hyrjes. Amadeus mund te pezulloje menjehere hyrjen e Pajtimtarit ne Sistemin Amadeus apo cdo Produkt Amadeus, apo te marre masa te tjera rreguluese, (nje **“Pezullim”**) pa asnje pergjegjesi ndaj Pajtimtarit, nese: (a) Pajtimtari nuk eshte ne perputhje me politikat Amadeus te njoftuara te cilat lidhen me perdorimin e tij te Sistemit Amadeus apo nje Produkt Amadeus, apo cdo ligj, rregull, rregullore, urdher apo udhezim; (b) Amadeus beson se po shkaktohet nje abuzim apo keqperdorim i Sistemit Amadeus apo nje Produkti Amadeus, i lejuar apo mundesuar nga Pajtimtari apo ne emer te Pajtimtarit; (c) Pajtimtari tenton modifikime te paautorizuara te Sistemit Amadeus apo nje Produkti Amadeus; (d) Hyrja e Pajtimtarit ne Sistemin Amadeus apo nje Produkt Amadeus shkakton (p.sh. nepermjet perdorimit te programit robotik): (i) nje degradim te Sistemit Amadeus apo nje Produkti Amadeus; (ii) nnderhyrje ne perdorimin e Sistemit Amadeus apo nje Produkti Amadeus nga perdoruesi apo kliente te tjere; apo (iii) nje kusht qe mund te vendose Amadeus ne shkelje te mundshme apo aktuale te marreveshjeve te tij me palet e tjera; (e) Amadeus identifikon nje situat e cila paraqet nje impakt te mundshem aktual apo potencial (ne opinionin e arsyeshem te Amadeus) mbi Sistemin Amadeus apo cdo Produkt Amadeus (perfishire probleme teknike, risqe te sigurise, demtime, nderperje apo degradim te Sistemit Amadeus apo cdo Produkti Amadeus) apo ndryshe prek negativisht aftesine Amadeus per t’i ofruar sherbimet Pajtimtarit apo perdoruesve te tjere, apo rezulton ne nje perdorim joefikas apo jo te duhur te Sistemit Amadeus apo cdo Produkti Amadeus; (f) Pajtimtari kryen cdo veprim apo mosveprim qe, sipas mendimit te Amadeus, mund te perbeje nje kercenim per Sistemin Amadeus, cdo Produkti Amadeus apo stabiliteti financiar te Amadeus, sigurise se informacionit/te dhenave apo te drejteve te autorit; (g) Pajtimtari identifikohet si jo-aktiv apo nuk i drejtohet korrespondences, korektimeve apo kerkesave ne lidhje me Sistemin Amadeus apo Produktin Amadeus te zbatueshem; (h) Amadeus, duke vepruar ne menyre te arsyeshme, beson se Pajtimtari apo cdo Perdorues i Autorizuar eshte, apo ka qene, i perfshire ne ndonje veprimtar mashtrimi apo te paligjshme; (i) Amadeus merr nje kerkese gjyqesore apo kerkese, urdher tjeter qeveritar apo kerkese permbarmore qe shprehimisht, apo me pasojte te arsyeshme, i kerkon Amadeus te veprojte keshtu; apo (j) Perdorimi nga Pajtimtari i Sistemit Amadeus apo Produktit Amadeus te zbatueshem shkel ne menyre thelbesore kete Marreveshje ne menyra te tjera.

Amadeus duhet, per aq sa lejohet nga ligji i zbatueshem, te njoftoje Pajtimtarin per cdo Pezullim ne menyren me te shpejte te arsyeshme. Nese Pezullimi rezulton nga veprimet apo mosveprimet e Pajtimtarit, nje Perdoruesi te Autorizuar apo cdo pale tjeter te trete sipas kontrollit dhe udhezimit te Pajtimtarit, dhe Pajtimtari nuk apo nuk mund te kujdeset per keto veprime apo mosveprime prenda 30 (tridhjte) diteve nga data e njoftimit te Amadeus, atehere Amadeus mund te perfundoje Marreveshjen pa asnje pergjegjesi kundrejt Pajtimtarit apo cdo pale tjeter.

3.2 Pezullimi i leshimit te biletave/Permbajtjes. Amadeus mundet, pa asnje pergjegjesi kundrejt Pajtimtarit, te pezulloje apo te kufizojte menjehere: (a) mundesine e Pajtimtarit per te leshuar bileta per Ofruesin(t) nese kjo kerkohet per cdo lloj arsye nga: (i) ky(keta) Pajtimtar(e); apo (ii) IATA, ARC apo cdo autoritet tjeter rregullator; apo (b) hyrjen e Pajtimtarit ne permbajtje specifike te Ofruesit nese kjo kerkohet per cdo lloj arsye nga ky Ofrues.

4. Sherbimet Amadeus

4.1 Sherbimet Amadeus. Amadeus do te ofrojte Sherbimet Amadeus te porositura nga Pajtimtari, perfishire cdo Dokumentacion te lidhur, per Pajtimtarin sipas kushteve te Marreveshjes.

4.2 Licenca. Amadeus nepermjet ketij dokumenti i jep Pajtimtarit nje te drejte jo-ekskluzive, te revokueshme dhe te pa-transferueshme, pa te drejten e dhenies se nen-licence, per te lejuar Perdoruesit e Autorizuar te perdorin cdo Sherbim Amadeus te porositur nga Pajtimtari vetem ne lidhje me hyrjen e Pajtimtarit ne dhe perdorimin e Sistemit Amadeus ne Territor.

4.3 Kredencialet e Porositese se Hyrjes. Pajtimtari do t’i kaloje Amadeus emrat dhe mbiemrat e plote dhe adresat e email te punes ekskluzivisht te perdorura nga ata Perdorues te Autorizuar te cilet jane te autorizuar nga Pajtimtari per te perdorur nje Sherbim Amadeus. Amadeus ne vijim do te pajise Pajtimtarin me Kredencialet e Hyrjes qe ai ka porositur dhe nje URL per te marre Sherbimin Amadeus perkates. Pasi Perdoruesi i Autorizuar te kete autentifikuar hyrjen e tij, ai mund te hyje ne Sherbimin Amadeus perkates. Cdo Perdorues i Autorizuar do te kete mundesine te ndryshoje passwordin e tij ne ekranin e hyrjes se Sherbimit Amadeus perkates. Pajtimtari mund te modifikojte, shjojte dhe heqe Kredenciale te Hyrjes duke perdorur proceduren e zakonshme te porositese Amadeus apo mjete te tjere

te mundesuar nga Amadeus here pas here. Keto veprime duhet te behen ne perputhje me kushtet financiare, teknike dhe kontraktuale te zbatueshme nga Amadeus ne daten e ketij veprimi dhe, nese jane porositur Kredenciale Hyrje te reja, te jene objekt i Tarifimit te zbatueshem per Perdorues te Autorizuar.

4.4 Kredencialet e Hyrjes. Pajtimtari angazhohet qe: (a) numri maksimal i Perdoruesve te Autorizuar qe ai ka autorizuar per te hyre dhe perdorur Sherbimet Amadeus te mos kaloje numrin e Kredencialeve te Hyrjes qe ai ka porositur here pas here; (b) te mos lejoje asnje Kredencial Hyrje te perdoret nga me shume se nje Perdorues i Autorizuar individual pervec nese i eshte ri-aktuar ne teresine e tij nje Perdoruesi te Autorizuar tjetër individual, rast ne te cilin Perdoruesi i Autorizuar i meparshem nuk do te kete me drejten per te hyre apo perdorur Sherbimet Amadeus; (c) ai do te lejoje Amadeus te kontrolloje Sherbimet Amadeus ne menyre qe te percaktoje emrin dhe Kredencialet e Hyrjes te cdo Perdoruesi te Autorizuar. Ky kontroll mund te behet jo me shpesh se nje here ne tremujor, me shpenzimet e Amadeus, dhe kjo e drejte do te ushtrohet me njoftim paraprak te arsyeshem, ne menyre te tille qe te mos nderhyje ne menyre thelbesore me ushttrimin normal te biznesit nga Pajtimtari; (d) nese ndonje nga kontrollat e referuara ne seksionin 4.4(c) me lart identifikon se Kredencialet e Hyrjes i jane dhene cdo individ qe nuk eshte nje Perdorues i Autorizuar atehere, pa parajgykar te drejten e tjera te Amadeus, Pajtimtari do te nderperse menjehere keto Kredenciale Hyrje dhe Amadeus nuk do te leshoje asnje Kredencial Hyrje te ri per asnje nga keto individ; dhe (e) nese ndonje kontroll referuar ne seksionin 4.4(c) gjen se Pajtimtari ka paguar me pak Detyrimet ndaj Amadeus atehere, pa parajgykar te drejten e tjera te Amadeus, Pajtimtari brenda 10 (dijete) diteve nga data e kontrollit perkates do t'i paguaje Amadeus nje shume te barabarte me kete pagese te kryer me pak, sipas llogaritjes ne perputhje me gnimet e percaktuara ne Shtojcat e Marreveshjes.

5. Programi Amadeus

5.1 Licenca e Programit. Nese Pajtimtari porosit nje Program qe nuk eshte ofruar si pjese e Sherbimeve Amadeus, Amadeus nepermjet ketij akti i jep Pajtimtarin nje te drejte jo-ekskluzive, te revokueshme, te pa-transferueshme dhe qe nuk jepet me nen-licence per te perdorur versionin e Programit vetem ne lidhje me hyrjen dhe perdorimin e Pajtimtarit te Sistemit Amadeus ne Territor.

5.2 Perdorimi i Programit. Pajtimtari mundet: (a) te perdore nje kopje prodhimt per cdo licence te dhene; dhe (b) te kopjoj Programin ne makinen lexuese vetem per ruajtje (*backup*), dhe te kopjoj Dokumentacionin perkates, me kusht qe te gjitha kopjet dhe kopjet e pjesshme te perfshijne njoftimet e te drejtave te autorit te Amadeus apo te licencuesve te tij, sipas rasti.

5.3 Permiresimet e Programit. Amadeus do t'i ofroje Pajtimtarit informacionin mbi perditesimet, rishikimet, permiresimet, modifikimet apo zevendesimet ne Program (secili, nje "**Permiresim i Programit**") dhe Tarifimin shtese, nese ka, per keto Permiresime te Programit ne leshimin e tyre. Cdo Tarifim shtese per nje Permiresim Programi do te behet i pagueshem brenda 30 (tridijete) diteve nga leshimi i Permiresimit te Programit Pajtimtarit pervec nese ai i ka kthyer Permiresimin e Programit te paperdorur Amadeus brenda kesaj periuode. Pajtimtari duhet te instaloje apo te lejoje Amadeus te instaloje Permiresime te Programit jo-opcionale, te ofruara nga Amadeus pa pagese, brenda 30 (tridijete) diteve nga njoftimi i Amadeus. Pervec kur Amadeus njofton me shkrim, Pajtimtari do te zevendesojë versionin aktual te Programit me Permiresimin e Programit me te fundit te disponueshem brenda nje periuode te arsyeshme pasi Amadeus ka bere te disponueshem nje Permiresim Programi. Pajtimtari kupton se ai mund te mos jete i afte te perdore nje Permiresim te Programit nese ai ka bere programe derivative apo modifikime ne Program apo pajisjen e perdorur per te hyre ne Sistemin Amadeus. Pajtimtari autorizon Amadeus te kryeje kontrole *online* te pajisjes dhe Programit te perdorur nga Pajtimtari per te verifikuar instalimin e rregullt te Permiresimeve te Programit.

6. Produktet Amadeus Shtese & Trajnimi

6.1 Produktet Amadeus Shtese. Amadeus mund t'i ofroje Pajtimtarit Produktet Amadeus shtese. Pervec kur eshte rene dakort ndryshe me shkrim nga Palet, te gjitha Produktet Amadeus shtese jane objekt i ketyre Kushteve Standarde te Hyrjes Amadeus dhe Tarifave ne fuqi ne daten e perdorimit te pare nga Pajtimtari, te cilat perbejne marreveshjen e Pajtimtarit per keto terma dhe kushte.

6.2 Faqja e internetit e Pajtimtarit. Nese Pajtimtari porosit, dhe Amadeus bie dakort me shkrim te ofroje, cdo Produkt Amadeus te perdorur per te bere Rezervime ne nje Faqe interneti: (a) Pajtimtari do te jete pergjegjes i vetem per te gjitha demtimet dhe pergjegjesite te cilat linden nga apo te lidhura me mashtrimi, abuzimi apo keqpërdorimi i kartave te kreditit nga Perdoruesit Online te cilet blejne produkte dhe sherbime ne apo nepermjet Faqes se internetit. Pajtimtari do te demshperbeje Grupin Amadeus dhe nen-kontraktoret e tij, kundrejt te gjitha pretendimeve, demtimeve, kostove apo shpenzimeve te cilat linden nga apo ne lidhje me cdo mashtrim, abuzim apo keqpërdorim te kartave te kreditit nga nje Perdorues Online; dhe (b) Pajtimtari do te mundesojë perjashtim standard pergjegjesie dhe politika per te dhenat personale ne Faqen e internetit ("**Mos-mbajtje pergjegjesie ne Faqen e Internetit**") duke mbrojtur Grupin Amadeus. Minimalisht, perjashtimi i pergjegjesise ne Faqen e Internetit duhet te perfshije nje gjuhe me ane te se ciles, ne asnje rast dhenei i te dhenave apo informacionit ne Faqen e internetit, perfshire Amadeus IT Group, S.A. apo filialet e tij. Ofruesit dhe licencuesit, nuk eshte pergjegjes per asnje kerkese, pretendim apo demtim, perfshire ato direkte, indirekte, si pasqje, te posaqme, ndeshkuese apo cdo demtim tjetër apo humbje ekonomike, qe rezultojn nga hyrja e Perdoruesit Online, perdorimin e, dhe blerjen e cdo produkti apo sherbimi ne Faqen e internetit. Perjashtimi i pergjegjesise ne Faqen e internetit duhet te shfaqet dukshem ne Faqen e internetit dhe te pranohet nepermjet nje pike dhe procesi klikimi nga Perdoruesit Online ne kohen e apo para rezervimit. Pajtimtari do te liroje, mbroje dhe mbaje te pademtuar Grupin

Amadeus nga cdo pretendim nga nje Perdorues Online apo cdo pale tjetër e trete qe lind apo lidhet me perdorimin e Sistemit Amadeus dhe do te demshperbeje Grupin Amadeus nga te gjitha pretendimet, demtimet, kostot apo shpenzimet te cilat linden apo ne lidhje me nje pretendim te tille nga nje Perdorues Online apo cdo pale tjetër e trete.

6.3 Produktet Publicitare. Nese Pajtimtari porosit cdo Produkt Amadeus qe perçon publicitet apo mesazhe marketingu tek klijentet e Pajtimtarit (secili, nje "**Produkt Publicitar Amadeus**"): (a) Pajtimtari do te konsiderohet se udhezoi Amadeus t'i ofroje Pajtimtarit kete Produkt Publicitar Amadeus kur porositet; (b) Amadeus do t'i dergoje publicitet klienteve te Pajtimtarit vetem nepermjet ketij Produkti Publicitar Amadeus; (c) Amadeus do te Perpunoje te Dhenat Personale per te ofruar kete Produkt Publicitar Amadeus ne perputhje me udhezimet specifike te Pajtimtarit, te cilat mund te perfshijne udhezime per te perpunuar informacion, perfshire te Dhenat Personale ne PNR; (d) Pajtimtari do te jete i informuar rreth dhe te jete ne perputhje me te gjitha ligjet e zbatueshme per produktet publicitare dhe te marketingut, perfshire cdo kerkese per te dhene njoftimet e duhura per, dhe te marre lejet e nevojshme nga, klientet e tij; (d) Pajtimtari do te demshperbeje Amadeus kundrejt pretendimeve, demtimeve, kostove apo shpenzimeve te cilat linden nga apo ne lidhje me mungesen e plotesimit te njoftimeve, lejeve apo kerkeseve te tjera te nevojshme sipas ligjit te zbatueshem; dhe (e) Amadeus nuk deklaroi apo garanton se publicitetet jane ne perputhje apo te pershtatshme me ligjin. Amadeus nuk merr asnje detyrim per permbytjen e publicitetit dhe nepermjet ketij dokumenti mohan cdo pergjegjesi per perdorimin e cdo publiciteti nga Pajtimtari.

6.4 Raportimi dhe Produktet e Inteligjences se Biznesit. Ne menyre qe marre akses ne raportet te cilat permbajne te Dhenat Rezervimi apo ne cdo Produkt Amadeus te perdorur per inteligjencen e biznesit, Pajtimtari duhet t'i jape Amadeus listen e Dokumentave te Identifikimit te Zyres se zoteruar nga Pajtimtari. Pajtimtari eshte pergjegjes per t'i komunikuar Amadeus cdo ndryshim ne listen e Dokumentave te Identifikimit te Zyres menjehere sapo ky ndryshim te ndodhe. Pajtimtari ka te drejten te perdore raportet dhe te dhenat e mundesuar nga Amadeus ("**Te Dhenat e Tregut**") ne perputhje me termat dhe kushtet e Marreveshjes. Te Dhenat e Tregut: (a) duhet te perdoren nga Pajtimtari vetem per marketimin dhe shitjen e sherbimeve te tij te udhetimit dhe zhvillimin efikas te biznesit te tij te udhetimit; dhe (b) jane per perdorim ekskluziv te Pajtimtarit dhe nuk do te botohen, publikohen apo t'i behen te mundshme asnje pale te trete, teresisht apo pjeserisht, ne formen e tij origjinale, apo te ri-rregulluara apo perpunuara ne cdo forme apo menyre qofte.

6.5 Trajnimi. Pajtimtari duhet te siguroje qe vetem Perdoruesit e Autorizuar te cilet kane perfunduar ne menyre te kenaqshme nje Trajnim te ofruar apo te miratur nga Amadeus per perdorimin e Sistemit Amadeus dhe Produktet Amadeus. Amadeus do te ofroje trajnime me Tarifat e zbatueshme ne momentin e ofrimit. Pajtimtari eshte pergjegjes per te gjitha shpenzimet e rastit (p.sh. udhetimi, strehimi, ushqimi) te bera nga Perdoruesit e Autorizuar ne lidhje me kete trajnim.

7. Faqet e internetit te Pales se Trete / Lidhja

7.1 Faqet e internetit te Paleve te Trete. Pajtimtari eshte ne dijeni se Sistemi Amadeus apo Produktet Amadeus mund t'i mundesojne apo te asistojne Pajtimtarin te hyje ne permbytjen e faqes se internetit te, te perputhet me, dhe te bleje produkte dhe sherbime nga, palet e tjera nepermjet faqeve te internetit te paleve te trete apo funksioneve te tjera te internetit, dhe qe e ben kete vetem me riskun e tij te vetem. Amadeus nuk jep asnje deklarate apo garanci ne lidhje me permbytjen apo perdorimin e, apo korrespondences me, cdo faqe interneti te kesaj pale te trete, apo cdo transakcion te perfunduar, dhe cdo kontrate te lidhur nga Pajtimtari, me ndonje nga keto pale te trete. Pajtimtari eshte pergjegjes per te familjarizuar veten e tij me termat dhe kushtet e faqes se internetit te pales se trete para se te perdore faqen e internetit te kesaj pale te trete. Amadeus nuk mbeshtet as miraton faqet e internetit te asnje pale te trete apo permbytjen e tyre te bere te disponueshem nepermjet Sistemit Amadeus apo cdo Produkti Amadeus.

7.2 Rrjetet dhe Sistemet. Pajtimtari do te sigurohet se rrjetet sistemet e tij jane ne perputhje me specifikimet perkatese te njoftuara nga Amadeus here pas here.

7.3 Lidhja me Amadeus. Pajtimtari do te jete pergjegjesi i vetem per te bere dhe mbajtur lidhjet e rrjetit dhe rrjetet e komunikimit nga sistemet e tij me qendrat e te dhenave te Amadeus.

7.4 Lidhjet e Rrjetit dhe Pajisjet e Komunikimit. Amadeus nuk eshte pergjegjes per asnje vonesë, deshtim te dergimit, apo cdo humbje apo demtim tjetër qe rezultojn nga apo lidhet me lidhjet e rrjetit apo shkaktohet nga transferimi i te dhenave nepermjet pajisjeve te komunikimeve te Pajtimtarit, perfshire Internetin, dhe njohurite e Pajtimtarit qe Sistemi Amadeus dhe Produktet Amadeus qe perdor apo akseson Pajtimtari nepermjet ketyre lidhjeve ne rrjet apo pajisjeve te komunikimit mund te jete objekt i kufizimeve, vonesave dhe problemeve te tjera te ndodhura ne perdorimin e tyre.

8. Te Dhenat e Ofruesit / Rezervimet e Paperfunduara / Te dhenat e Rezervimit

8.1 Te Dhenat e Ofruesit. Ofruesit jane pergjegjesit e vetem per te siguruar qe te dhenat dhe informacioni i dhene dhe i ruajtur ne Sistemin Amadeus eshte i sakte dhe i perditesuar ne menyren e duhur. Pajtimtari nuk duhet te beje asnje rezervim per tarifa ku hetimi i arsyeshem i Pajtimtarit tregon qe ky informacion eshte dhene dhe ruajtur ne menyre jo te sakte ne Sistemin Amadeus nga nje Ofrues. Amadeus nuk jep asnje deklarate apo garanci ne lidhje me saktesine apo besueshmerine e te dhenave te Ofruesit apo cdo informacioni tjetër te dhene Pajtimtarit nepermjet Sistemit Amadeus. Perkatesisht, Amadeus nuk do te jete pergjegjes per permbytjen, saktesine, perdorimin apo vijimin e disponueshmerise te cdo te dhene te Ofruesit apo cdo informacioni tjetër te gjendur ne Sistemin Amadeus dhe Pajtimtari liron

dhe heq dore nga cdo pretendim kundrejt Amadeus ne lidhje me saktesine dhe besueshmerine e ketyre te dhenave dhe informacioni.

8.2 Rezervimet e Paperfunduara. Nese nje pasagjer i cili perdor nje rezervim te konfirmuar te bere nga Pajtimtari nepermjet Sistemit Amadeus i refuzohet sherbimi nga Ofruesi per shkak te nje mbi-shitje apo per shkak te mungeses se regjistrimit per kete rezervim, apo nje Ofruesi i ka dhene te dhena jo te sakta Amadeus, rregullimi i vetem do te jete i dhene nga ky Ofrues ne tarifat e tij apo termat dhe kushtet e kontrates se Ofruesit te zbatueshme per Pajtimtarin apo pasagjerin.

8.3 Te Dhenat e Rezervimit. Pajtimtari duhet te: (a) regjistroje, perditesojë dhe mbaje ne menyre te sakte te Dhenat e Rezervimit; dhe (b) te kete pergjegjesi personale per ligjshmerine, saktesine dhe cilesine e te Dhenave te Rezervimit. Nese Amadeus percakton se nje e Dhenë Rezervimi eshte e pasakte, ç'orientuese, shpifese, mashtruese apo e paligjshme, Amadeus mund te njoftojë Pajtimtarin dhe te pezulloje hyrjen ne keto te Dhenat Rezervimi nese Pajtimtari nuk nderrmerr veprime korrigjuese brenda periuodes kohore te njoftuar.

8.4 Franchising/Konsorcium. Nese Pajtimtari eshte anetar i nje franchising, konsorciumi apo grupi tjetër perfaqesimi, Pajtimtari lejon dhenien e te Dhenave te tij te Rezervimit (pa perfshire te Dhenat Personale) per zyrtar qendrorë te ketij grupi.

8.5 Itineraret dhe Sherbimet Shtese. Amadeus mund: (a) te perdore te Dhenat e Rezervimit per te dhene nje itinerar dhe informacione te tjera; dhe (b) t'i ofroje sherbime shtese, drejteperdrejte udhetare nepermjet CheckMyTrip apo nje faqe interneti apo program telefoni i njeje.

8.6 Identifikimi i Pajtimtarit. Pajtimtari pranon te identifikohet ne cdo te dhene marketingu, rezervimi dhe shitje qe cdo entitet brenda Grupit Amadeus vendos te beje te disponueshme. Keto te dhena marketingu, rezervimi dhe shitje te bera te disponueshme nga Amadeus nuk duhet te perfshijne identifikimin, si direkt apo indirekt, te individit apo, nese zbatohet, te organizatave apo shoqerive ne emer te te cileve ata po veprojne. Ne kembim, Amadeus do t'i beje te disponueshme Pajtimtarit raportin duke perfshire te dhenat e mbledhura te rezervimeve ajrore te ofruara pajtimtareve duke mbuluar te gjitha shtetet objekt i Kodit te Sjelljes per CRS te BE, i njohur si "Analiza e Rezervimeve Amadeus", sipas nje marreveshje te vecante qe do lidhet nga Palet.

9. Garancite

9.1 Garancia e Performances se Programit. Amadeus garanton qe Programi ne thelb perputhet me Dokumentacionin e publikuar. Nese Pajtimtari njofton Amadeus me shkrim per nje defekt, si korigjim i vetem i Pajtimtarit per nje shkelje thelbesore te kesaj garancie, Amadeus mundet: (a) me bashkepunimin e arsyeshem te Pajtimtarit, te konfirmojë ekzistencen e ketij defekti dhe me pas te korrigoje apo zevendesojë cdo Program me defekt; apo (b) te anulroje Programin nga Marreveshja dhe te jape nje rimbursim proporcional te cdo tarife licence te parapaguar me kthimin e Programit. Kjo garanci nuk zbatohet per Programin qe eshte modifikuar apo shtuar nga Pajtimtari apo furnitoret e tij.

9.2 Patenta e Programit / Garancia e te Drejtave te Autorit. Amadeus garanton se ne njohurite me te mira te tij pjesa e Programit e shkruar nga Amadeus apo Grupi Amadeus ne apo para Dates Efektive nuk shkel patentat apo te drejta e autorit te paleve te trete. Si mjeti i vetem dhe ekskluziv i Pajtimtarit per nje shkelje thelbesore te kesaj garancie, Amadeus do te mbroje Pajtimtarin kundrejt cdo pretendimi qe ne Datën Efektive pjesa e Programit e shkruar nga Amadeus apo Grupi Amadeus shkel nje patente apo te drejte autori te vlefshme. Amadeus apo nje nga filialet e tij do te paguaje te gjitha demtet direkte te dhena ne forme te prere, plus te gjitha tarifat e akovate dhe kostot e lidhura ligjore, te cilat linden nga ky pretendim, me kusht qe Pajtimtari t'i jape Amadeus menjehere njoftim me shkrim per kete pretendim, informacion dhe asistencë te arsyeshme, dhe autoritet te vetem per te mbrojtur apo per te zgjidhur me marreveshje kete pretendim. Ne mbrojtje apo zgjidhje me marreveshje Amadeus mundet sipas vullnetit te tij te vetem: (a) te marre per Pajtimtarin te drejten per te vazhduar te perdore Programin; apo (b) te zevendesojë apo modifikojë ate (pa ndryshuar ne menyre thelbesore funksionet e tij) ne menyre qe te mos jete ne shkelje/cenim. Nese Amadeus vendos sipas vullnetit personal te tij se keto masa/korigjime nuk jane te mundshme ne menyre te arsyeshme, Amadeus mund te ndaloje perdorimin e Programit dhe t'i jape Pajtimtarit nje kompensim proporcional per cdo tarife licence te parapaguar me kthimin e Programit dhe Dokumentacionit. Kjo garanci nuk zbatohet nese: (i) Pajtimtari ben ndryshime apo shtesa ne Program; (ii) shkelja e pretenduar bazohet ne perdorimin apo shitjen e Programit apo pajisjes Amadeus ne kombinim me produkte jo te ofruara nga Amadeus; apo (iii) Pajtimtari deshton ne instalimin e Programit te ofruar nga Amadeus dhe instalimi i ketij Programi do te kishte parandaluar shkeljen e pretenduar.

10. Pronesia

Cdo dhe te gjitha te drejta e pronesisë intelektuale dhe te drejta e tjera te pronesisë per Sistemin Amadeus, Programin, Produktet Amadeus apo Sherbimet Amadeus, dhe i gjithe Dokumentacioni i lidhur, njohuria, shkrimi, projekti i ekranit, procesi i punes dhe konceptet e programit, jane pronesi e Amadeus apo licencuesve te tij dhe perben pronesine intelektuale, informacionin pronesor dhe sekretin tregtar te Amadeus dhe licencuesve te tij. Amadeus apo licencuesit e tij kane te gjitha te drejta, titujt dhe pjesemarrjet ne kete pasuri, perfshire cdo dhe te gjitha zhvillimet e bera nga Grupi Amadeus apo entitetet filiale te tij apo ne emer te tyre.

11. Siguria / PCI-DSS

11.1 Kerkaset e Sigurise. Pajtimtari eshte ne dijeni dhe pranon qe mjedisi ne te cilin perdolet Sistemi Amadeus dhe Produktet Amadeus duhe te jete i sigurte. Perkatesisht, Pajtimtari duhet (dhe duhet te siguroje qe cdo nenkontraktor apo pale e trete tjetër qe ofron sherbime te teknologjise ne informacionit ne emer te tij do te): (a) zbatojë dhe mbaje aktive firewalls per

te kufizuar dhe kontrolloje trafikun hyres mbi sistemet kompjuterike te klientit te pajtimtarit; (b) zbatoje dhe mbaje aktive dhe te perditesuara rregullisht anti-viruse dhe mjete anti-*malware* ne te gjitha kompjuterat; (c) perdore vetem versione te mbeshtetura, te perditesuara dhe konfiguruar te programit kompjuterik, sistemeve operative dhe perberesve te infrastruktures, me te gjitha perditesimet e sigurise te zbatuara sa me shpejte te jete e mundur; (d) siguroje qe Perdoruesit e Autorizuar perdorin passworde te forta pa perhapur Kredencialet e Hyrjes midis disa individeve apo te riperdorin te njeitin fjale kyce ne disa produkte apo mjete, duke nenkuptuar se te gjitha Perdoruesit e Autorizuar duhet te perdorin fjale kyce unike per Sistemin Amadeus dhe cdo Produkt Amadeus, perfshire llogarin e e-mailit te punes se tyre; dhe (e) kryeje seanca ndergjegjesimi per te gjitha Perdoruesit e Autorizuar mbi menyren per te njohur dhe parandaluar perpjekjet mashtruese (*phishing*).

11.2 Kredencialet e Hyrjes. Amadeus do t'i jape Pajtimtarit Kredencialet e Hyrjes per Perdoruesit e Autorizuar per te hyre dhe perdorur Sistemin Amadeus dhe cdo Produkt Amadeus apo, nese eshte i disponueshem ne Territor, Amadeus Direct. Pajtimtari do te zbatoje dhe mbaje procedura administrative te pershtatshme per te siguruar qe Kredencialet e Hyrjes t'i jepen vetem Perdoruesve te Autorizuar. Pajtimtari eshte pergjegjes i vetem per: (a) sigurine dhe perdorimin e Kredencialeve te Hyrjes se Pajtimtarit dhe Perdoruesve te Autorizuar te tij; dhe (b) gjitha hyrjet ne dhe perdorimin e Sistemit Amadeus dhe cdo Produkt Amadeus direkt apo indirekt nga apo nepermjet infrastruktures se teknologjise se informacionit te Pajtimtarit apo Kredenciale te Hyrjes se Perdoruesve te Autorizuar te tij, me apo pa dijeni apo lejen e Pajtimtarit. Pajtimtari do te heqe menjehere Kredencialet e Hyrjes nga personat te cilet nuk kualifikohen me si Perdorues te Autorizuar.

11.3 Hyrje apo Perdorim i Pa-autorizuar. Pajtimtari duhet te vendose te gjitha kontrolet fizike, administrative dhe teknike, procedurat e monitorimit dhe sigurise dhe masa te tjera mbrojtese te nevojshme per te administruar ne menyre te sigurte shperndarjen dhe perdorimin e te gjitha Kredencialeve te Hyrjes dhe te parandaloje cdo hyrje te pa-autorizuar ne, apo perdorimin e Sistemit Amadeus apo Produktin Amadeus te zbatueshem dhe, ne rastin e cdo hyrje apo perdorimi te tille te pa-autorizuar, te njoftoje menjehere Amadeus.

11.4 PCI-DSS. Amadeus dhe Pajtimtari secili jane pergjegjes per sigurine e te dhenave te mbajtesit te kartes qe jane te ruajtura apo perpunuara ne apo te trasmetuara nepermjet sistemeve te tyre perkatese dhe bien dakort te bashkepunojne per te mbajtur kete siguri per te mundesuar Amadeus te certifikoj cdo vit per Standardin e te Dhenave te Industrise se Pageses me Karte ("PCI-DSS") sipas publikimit dhe mandatimit nga Keshilli i Standardeve te Sigurise PCE ne kohen e certifikimit, ne lidhje me ruajtjen, trasmetimin dhe perpunimin e te dhenave te mbajtesit te kartes te cilat i perkasin udhetareve.

11.5 Hyrja e te Dhenave. Ne perdorimin e Sistemit Amadeus apo cdo Produkti Amadeus, Pajtimtari bie dakort qe te gjitha te dhenat e mbajtesit te kartes te vendosura nga apo ne emer te Pajtimtarit do te futen vetem ne fushat e perkatese (p.sh. fushat e profilit PNR apo te udhetarit) te krijuara here pas here nga Amadeus dhe per te cilat Amadeus zbaton enkriptim. Keto fusha ne PNR dhe profil perfshijne:

(a) **Elementet PNRs:**

Komanda Kriptike	Emri i elementit
FP	Forma e pageses
INS	Non-elementet e formes se pageses ne elementet e sigurimit
MCO, XSB, and SVC	Non-elementet e formes se pageses ne dokumenta te ndryshme
NFP	Forma neutrale e pageses
SSR FOID	Kerkese per sherbimet te posaqme per formen e identifikimit
RM, RC, RX, RY, RI and RQ	Observacione
SSR EPAY	Kerkese per sherbim te posaqem per pagese elektronike
/G	Fushat e garancise per segmentet e hotelit dhe makines
/DP	Fushat e depozites per segmentet e hotelit dhe makines

(b) **Elemente te profilut:**

Komanda Kriptike	Emri i elementit
FP	Forma e pageses
SR FOID	Kerkese per sherbimet te posaqme per formen e identifikimit
SR EPAY	Kerkese per sherbimet te posaqme per formen e identifikimit
RM	Shenime te pergjithshme
RC	Shenim konfidencial

Komanda Kriptike	Emri i elementit
RQ	Sheime per kontrollin e cilesise
RX	Shenim i korporates
RIR	Shenim i itinerarit
PPR	Linja e perparesis
PPS	Regjistrime te para-ruajtura
RY	Shenim RY
PHI	Fushat e garancise per segmentet e hotelit
PCI	Fushat e garancise per segmentet e makines

11.6 Kerkesa Sigurie Shtese. Pajtimtari duhet (dhe duhet te siguroje se cdo nen-kontraktor apo pale e trete tjetere e cila ofron sherbime te teknologjise se informacionit ne emer te Pajtimtarit do te) zbatoje, mbaje dhe te jete ne perputhje me kerkesat, politikat apo standardet shtese te sigurise se informacionit te percaktuara nga Amadeus dhe te komunikuar Pajtimtarit here pas here. Pajtimtari duhet te marre masa te menjehershme te nevojshme per te zbatuar keto kerkesa me koston e tij dhe, ne ne cdo rast, jo me vone se afati i caktuar.

11.7 Palet e Treta te Pajtimtarit. Pajtimtari duhet te njoftoje Amadeus nese ai deshiron te lidhet me pale te trete furnitore apo partnere (p.sh. nje ofrues pagesash) per Sistemin Amadeus apo nje Produkt Amadeus (nje "**Pale e Trete e Pajtimtarit**"). Lidhja me cdo Pale te Trete te Pajtimtarit ne Sistemin Amadeus apo nje Produkt Amadeus do te jete objekt i lejes paraprake me shkrim te Amadeus dhe kushtet ne vazhdim si vijon: (a) Amadeus mund te vendose, here pas here, kushte perdorimi apo masa sigurie te zbatueshme per Palet e Treta te Pajtimtarit, per te cilat eshte pergjegjes Pajtimtari per zbatimin me Palet e Treta te Pajtimtarit; (b) Pajtimtari duhet te siguroje qe cdo Pale e Trete e Pajtimtarit eshte ne perputhje te plote ne cdo kohe me PCI-DSS dhe duhet t'i jape Amadeus prova te zbatimit te ketyre PCI-DSS sipas kerkeses; (c) Amadeus mundet te shkepuse lidhjen menjehere dhe pa njoftim cdo Pale te Trete te Pajtimtarit e cila shkel apo nuk zbaton plotesisht cdo detyrim PCI-DSS; and (d) Amadeus nuk do te kete pergjegjesi per kryerjen apo plotesimit e PCI-DSS nga cdo Pale e Trete e Pajtimtarit.

11.8 Kerkesat e Mos-respektimit te Projektit. Amadeus nuk do te kerkohet te zhvilloje, prese apo zbatoje asnje zhvillim, dhe nuk ofron asnje garanci te lidhur me sigurine ne kete aspekt, per aq sa kerkesat e shvillimit te Pajtimtarit jane jo ne perputhje apo ne konflikt me standardet e sigurise PCI-DSS apo Amadeus apo jane ndryshe ne ne konflikt me ligjet, rregulloret apo standardet industriale te detyrueshme ne fuqi. Ne lidhje me zhvillimet e pritura nga jashte, Amadeus mund te pranoje te keto zgjidhje jo ne perputhje me kusht qe Pajtimtari te liroje Amadeus dhe filialet e tij nga cdo dhe te gjitha pergjegjesite, cdo humbje, demtim, shpenzim apo lendim dhe cdo dhe te gjitha pretendimet qe mund te kete ne te ardhmen kundrejt Amadeus dhe filialeve te tij si rezultat i zhvillimit apo zbatimit te zgjidhjes, perfshire cdo deshtim per te qene ne perputhje me PCI-DSS.

11.9 Pezullimi. Amadeus mund te pezulloje menjehere hyrjen e Pajtimtarit ne Sistemin Amadeus apo nje Produkti Amadeus, apo te marre masa te tjera korrigjuese, pa asnje pergjegjesi ndaj Pajtimtarit, nese Pajtimtari deshton te zbatoje kete Seksion.

11.10 Demshperblimi. Pajtimtari pranon se nje deshtim per te zbatuar kete Seksion mund te rrezikoj mejeten e perdoruesit fundor ne te cilen perdoren Sistemi Amadeus apo Produktet Amadeus, qe mund te coje ne mashtrim, keqperdorim apo shkelje te te dhenave. Perkatesisht, Pajtimtari duhet te demshperbleje entitetet e zbatueshme brenda Grupit Amadeus kundrejt te gjitha pretendimeve, pergjegjesive, gjobave, demtimeve dhe kostove dhe shpenzimeve te lidhura te cilat lindin nga apo ne lidhje me: (a) deshtimin e Pajtimtarit per te zbatuar, mbajtur apo per te qene ne perputhje me cdonjerin nga kerkesat, politikat apo standardet e sigurise ne kete Seksion apo te komunikuar Pajtimtarit sipas Seksionit 11.6 me lart; (b) zhvillimin e nje zgjidhje mos-perputhje sipas Seksionit 11.8 me lart.

12. Ushtrimi i Biznesit

Amadeus dhe Pajtimtari duhet te aderojne ne standardet me te larta te etikes, integritetit dhe trajtimit te drejte te biznesit dhe nuk do te bejne asgje qe do te tentojte te diskreditoje apo ne cdo menyre te demtojte emrin e mire dhe vullneitin e mire te tjetrit apo filialeve te tij.

13. Modifikimi

Amadeus ruan te drejten, sipas vullnetit te tij te vetem, te modifikoj ne cdo kohe keto Kushte Standarde te Hyrjes Amadeus ("**Modifikimet**") duke njoftuar Pajtimtarin per keto Modifikime. Pavaresisht cdo gjeje te kundert ne Marreveshje, Amadeus mund te njoftoje Pajtimtarin per cdo modifikim duke publikuar Kushtet Standarde te Hyrjes Amadeus te modifikuara ne: <https://amadeus.com/documents/en/travel-channels/legal/amadeus-standard-terms-of-access.pdf> Modifikimet nuk do te kene fuqi prapavepruese dhe do te hyjne ne fuqi 30 (tridhjte) dite pas njoftimit. Megjithate, Modifikimet specifike per nje funksion apo ndryshim te bera per qellime ligjore do te hyjne ne fuqi menjehere pas njoftimit. Pajtimtari njeher pergjegjesine e tij per te kontrolluar rregullisht Kushtet Standarde te Hyrjes Amadeus per Modifikime. Nese ndonje Modifikim eshte i papranueshem nga Pajtimtari, atehere Pajtimtari mund te zgjidhe kete Marreveshje apo, nese zbatohet, Produktin Amadeus perkates duke njoftuar Amadeus me shkrim brenda 30 (tridhjte) diteve nga njoftimi i Modifikimit nga Amadeus. Vazhdimi i perdorimit nga Pajtimtari i

Sistemit Amadeus apo nje Produkti Amadeus 30 (tridhjte) dite pas njoftimit te Modifikimeve nga Amadeus do te thote se Pajtimtari konsiderohet se ka pranuar dhe ka rene dakort me keto Modifikime.

14. Vlefshmeria e Pjesshme

Nese ndonje nga keto dispozita te ketyre Kushteve Standarde te Hyrjes Amadeus do te konsiderohet nga nje gjykate apo autoritet tjetere kompetent gjyqesor qe te perjashtohet apo te behet e pazbatueshme, keto dispozita do te kufizohen apo eliminohen ne shtrirjen minimale te nevojshme dhe zevendesohen nga nje dispozite e vlefshme e cila perfaqeson me mire qellimin e ketyre Kushteve Standarde te Hyrjes ne Amadeus, ne menyre qe keto Kushte Standarde te Hyrjes Amadeus te vazhdojne te mbesin ne fuqi dhe zbatim te plote.

15. Ligji i Aplikueshem dhe Juridiksioni

15.1 Ligji i Aplikueshem. Keto Kushte Standarde te Hyrjes Amadeus dhe cdo mosmarreveshje apo pretendim qe lind nga apo ne lidhje me to apo ceshtje te lidhjes apo objektit te tyre (perfshire mosmarreveshjet apo pretendimet jo-kontraktuale) do te rregullohen nga dhe interpretohen ne perputhje me ligjin e percaktuar ne Marreveshje, pa marre ne konsiderate asnje konflikt te ligjeve, rregullave apo parimeve qe mund te kerkoje zbatimin e cdo ligji tjetere apo kur Marreveshja apo ndryshimet e saj jane nenshkruar.

15.2 Juridiksioni. Secila Pale ne menyre te parevokueshme bie dakort se gjykatat e percaktuara ne Marreveshje do te kene juridiksion ekskluziv per te vendosur mbi cdo mosmarreveshje apo pretendim qe lind nga apo ne lidhje me keto Kushte Standarde te Hyrjes Amadeus apo ceshtje te lidhjes dhe objektit te tyre (perfshire mosmarreveshjet apo pretendimet jo-kontraktuale). Secila Pale heq dore per aq sa eshte e lejueshme nga ligji nga gjykimi me juri per te gjitha pretendimet te cilat lindin nga apo lidhen me keto Kushte Standarde te Hyrjes Amadeus.